



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 7172 Prot.
17

Tiranë, më 22.12.2021

Të dhëna mbi vendimin e APP Nr. 86, datë 22.12.2021

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" (në vijim "LPP") në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Eurogjici-Security" Shpk nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim për qëllime kualifikimi, në procedurat e prokurimit me objekt: *"Shërbim sigurie për ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave të Drejtorisë Rajonale Burrel OSSH, sh.a, me roje dhe sistem alarmi"* dhe *"Shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare për "FSHU" Sh.a"*, të zhvilluara nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH, Burrel (në vijim "AK") respektivisht, në datë 04.06.2021 dhe në datë 10.06.2021.

I. Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit, NIPT, adresa): "Eurogjici-Security" Shpk me NIPT K31929010K, me adresë: Rruga "Adem Jashari", Lagja nr. 8, Ndërtesa 4, Hyrja 10, Ap. 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Tiranë.

II. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Eurogjici-Security" Shpk, ka nisur mbi bazën e informacionit të dërguar nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (në vijim "ISHPSHSH"), në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve tona, ku rezulton se, operatori ekonomik "Eurogjici-Security", pas inspektimeve të kryera nga ky institucion, ka patur "gjobë" në fuqi të palikujduar, që nga data 18.03.2019.

III. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se nuk ndodheshim në kushtet e keqinformimit për qëllime kualifikimi, sipas parashikimeve të nenit 78/1/a të LPP.

IV. Masat:

Me Vendimin Nr 86, datë 22.12.2021, APP ka vendosur të mospërjashtojë operatorin ekonomik "Eurogjici-Security" Shpk, nga e drejta për të fituar kontrata publike, pasi nga dokumentacioni i administruar rezulton se, shoqëria "Eurogjici-Security" nuk ka keqinformuar

AK, pasi rezulton e provuar nga ISHPSHSH si dhe ISHPSHSH Drejtoria Rajonale Dibër se, operatori ekonomik "Eurogjici Security" Shpk, i cili ka marrë pjesë në procedurat e prokurimit të sipërcituara, në kohën e paraqitjes së deklaratës, në datë 04.06.2021 dhe në datë 10.06.2021, ku ka deklaruar se, *nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga ISHPSHSH*, nuk ka patur masë administrative "gjobë" në fuqi, pasi e ka likujduar gjobën në datë 29.05.2019.